

Nordrhein-Westfalen setzt vereinbarte Maßnahmen zur Bekämpfung des Corona-Virus konsequent um

Deklaratë për shtyp - 907/10/2020

Nordrhein-Westfalen implementon në vazhdimësi masat e rëna dakord për të luftuar koronavirusin

Qeveria e Landit ju komunikon:

Qeveria e Landit implementon në vazhdimësi masat e rëna dakord gjatë takimeve të udhëheqësve dhe udhëheqësve të qeverive të Landeve me kancelaren e Gjermanisë në datën 28 tetor.

Kryeministri Armin Laschet shprehet: „Situata është shumë serioze. Ne kemi nevojë për një përpjekje të fuqishme kombëtare për të parandaluar një emergjencë mjekësore. Për ta arritur këtë gjë, ne duhet të reduktojmë shpejt dhe vazhdimisht kontaktet dhe si rrjedhim të ulim sërish me sukses incidencën e infeksionit. Sistemi shëndetësor nuk duhet të mbingarkohet. Në të njëjtën kohë ne duhet të shmangim një mbyllje totale. Ne dëshirojmë që kopshtet, shkollat dhe sektori ekonomik të qëndrojnë hapur. Tani nevojitet solidaritet. Nordrhein-Westfalen mund ta bëjë këtë gjë. Ne e kemi vërtetuar tashmë këtë në mars dhe prill.

Ministri i Shëndetësisë Karl-Josef Laumann shprehet: „Numri i rasteve me koronavirus është rritur ndjeshëm. Ndërkohë ne po vëmë re pothuajse në të gjitha rajonet e Nordrhein-Westfalen një incidencë infeksioni shumë dinamike dhe të vazhdueshme. Vetëm procedurat vendimtare mund të ndihmojnë frenimin e kësaj rritje. Ne duhet të reduktojmë kontaktet sociale në minimum në mënyrë që të ndërpresim zinxhirin e transmetimit të infeksionit. Ne duhet të bëjmë çdo gjë të mundshme për të mbrojtur qytetarët dhe qytetaret tona të cilët janë veçanërisht të rrezikuar.”

Në mëngjesin e 30 tetorit, RKI raportoi 5.398 raste të reja me koronavirus në Landin e Nordrhein-Westfalen, ku vetëm 4.291 e të cilëve i përkasin ditës së djeshme. Incidenca javore e Landit (numri i rasteve në 7 ditët e fundit për 100.000 banorë) ka sot vlerën me tendencë në rritje prej 140. „Momentalisht çdo person i infektuar me koronavirus infekton të paktën 1.2 persona.

Nëse numri i infeksioneve vazhdon të rritet në mënyrë të shfrenuar, duhet të shqetësohemi se kapacitetet e lira të krevateve të kujdesit intensiv të pajisur me ventilatorë mund të zihen nga pacientët e infektuar me koronavirus para fundit të këtij viti”, u shpreh ministri Laumann.

Ministri vazhdoi: „Në atë rast do të duhet të merren masa të mëtejshme për të zgjeruar kapacitetin, veçanërisht kapacitetin e ventilatorëve. Njësoj si në mars do të na duhet të udhëzojmë spitalet të shtyjnë trajtimet e planifikuara ose përndryshe do na duhet të shfrytëzojmë kapacitetet tek klinikat e rehabilitimit në Nordrhein-Westfalen.

Duke patur parasysh këto ngjarje, Urdhëresa për Mbrojtjen nga Koronavirusi e cila ishte si fillim e vlefshme deri në 31 tetor, do të zgjatet me 1 ditë deri në 1 nëntor. Rregullat e reja vlejné si rrjedhim në Nordrhein-Westfalen duke filluar nga 2 nëntori, siç është rënë dakord në të gjithë Gjermaninë.

Ndër të tjera, rregullorja e re do ta bëjë edhe më të qartë rregullin e DHM (Distancë - Higjienë - Maska të përditshme) dhe do të përcaktojë shtrirjen e zbatimit të saj në mënyrë më të njëtrajtshme. Duke filluar nga 2 nëntori e më tutje vlen detyrimi thelbësor për mbajtjen e maskës së përditshme në ndërtesa ku ka lëvizje klientësh dhe vizitorësh. Një mesazh tjetër i rëndësishëm i rregullores së re është ky: Në mënyrë që të ulim valën e infeksionit, duhet të reduktohen sa më shumë në nëntor të gjitha kontaktet të cilat nuk kanë lidhje me shkollën, formimin profesional dhe punën.

Konkretisht kjo do të thotë se:

- Takimet në hapësira publike lejohen vetëm midis pjesëtarëve të bashkësive familjare të një personi dhe të një tjetri. Gjithsesi as në këto raste nuk lejohen më shumë se 10 persona.
- Në mjediset private duhet zbatuar rekomandimi urgjent për të shmangur totalisht kontaktin me personat jashtë bashkësisë familjare dhe aty ku është e mundur të mbahet parasysh rregulli i DHM.
- Ndalohet akomodimi për të kaluar natën për qëllime turistike. Kjo nuk vlen për qëndrimet gjatë gjithë natës në kontekstin e udhëtimeve të ndërmarra para 29 tetorit. Nuk lejohen udhëtimet në distanca të gjata me autobus dhe udhëtime të tjera në grup me autobus për qëllime turistike.

- Veprimtaritë gastronomike duhet të mbyllen. Këtu përjashtohet dërgesa ose marrja e ushqimit me vete për konsumim në shtëpi.
- Duhet të ndalohen të gjitha evenimentet të cilat zhvillohen për qëllime argëtimi dhe për të shpenzuar kohën e lirë.
- Duhet të mbyllen:
 - Teatrot, operat, sallat e koncerteve dhe hapësira të ngjashme
 - Panairët, ekspozitat, festivalet argëtuese vjetore, tregjet e sendeve të përdorura
 - Kinematë, parqet e argëtimit, kopshtet zoologjike dhe parqet e kafshëve dhe aktivitete të tjera të kohës së lirë (të brendshme dhe të jashtme)
 - Sallat e lojrave dhe kazinotë, pikat e basteve dhe mjedise të ngjashme
 - Sportet amatore dhe zbavitëse në të gjitha mjediset private dhe publike sportive, me përjashtim të sporteve individuale të zhvilluara në mjedise të jashtme
 - Pishinat për të notuar dhe për t'u zbavitur, palestrat dhe mjediset e ngjashme
 - Mjediset ku zhvillohet prostitucioni, shtëpitë publike dhe mjedise të ngjashme
- Ndalohen gjithashtu shërbimet të cilat zhvillohen në afërsi fizike me përjashtim të parukerive dhe kujdesit për këmbët si dhe shërbimeve të nevojshme mjekësore si fizioterapia.

Ministri i Shëndetësisë Karl-Josef Laumann: „Megjithëse do të ketë skema bujare kompensimi për veprimtaritë e mbyllura, masat tona mbeten të rënda, ne jemi të vetëdijshëm për këtë gjë. Ato godasin shumë biznese të cilat kanë punuar shumë në muajt e fundit për të mbrojtur klientët dhe vizitorët nga virusi. Por ne jemi të bindur se dëmi tek sektori i gastronomisë, kulturor, sportiv dhe i argëtimit do të jetë shumë herë më i madh nëse nuk arrijmë të frenojmë përhapjen e virusit me veprime vendimtare.”

Urdhëresa e re për Mbrojtjen nga Koronavirusi qëndron në fuqi deri në 30 nëntor dhe mund të shkarkohet [këtu](#)

Për pyetje si qytetar ju lutem telefononi tek: Telefon 0211 855-5.

Nëse keni pyetje në lidhje me zyrën e shtypit, ju lutem kontaktoni zyrën e shtypit të Ministrisë së Punës, Shëndetësisë dhe të Çështjeve Sociale, Telefon 0211 855-3118.

Kjo deklaratë për shtyp është gjithashtu në dispozicion tek www.land.nrw

[Shënim në lidhje me mbrojtjen e të dhënave në rrjetet sociale](#)